



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORI I PËRGJITHSHËM  
URDHËR**

**PËR  
MBAJTJEN, PLOTËSIMIN DHE RAPORTIMIN E TË DHËNAVE  
STATISTIKORE NË  
PROKURORI<sup>1</sup>**

***Me synim,***

- pasqyrimin në të dhënat statistikore të Prokurorisë të ndryshimeve dhe plotësimeve në legjislacionin penal;
- vendosjen e statistikës në baza më shkencore, për të njohur në çdo kohë gjendjen e treguesve të ndjekjes penale, të ngritjes së akuzës në gjykatë dhe të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale, si dhe që statistika t'i shërbejë punës kërkimore e studimore në Prokurori;
- rritjen e përgjegjshmërisë në plotësimin e saktë, përpunimin, analizën dhe ruajtjen e të dhënave statistikore, në prokuroritë e të gjitha niveleve;

***Mbështetur,*** në nenet 8 pika 2, 4 e vijues të ligjit Nr. 8737 datë 12. 02. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", në ligjin Nr.7687 datë 16. 03. 1993 «Për Statistikën», etj;

**U R D H Ë R O J**

**I, MBAJTJA E EVIDENCAVE STATISTIKORE SIPAS NIVELEVE TË PROKURORTVE:**

- 1.1. Prokuroritë pranë Gjykatave të rrethit gjyqësor të rrobajnë të dhenat statistikore, 3-mujore, 6-mujore, 9-mujore dhe vjetore, si më poshtë:
  - a. Evidenca e Referimeve të Veprave Penale, Model Pr 1R;
  - b. Evidenca e Masave të Sigurimit, Model Pr 1Ms;
  - c. Evidenca e Treguesve të Ndjekjes Penale sipas Veprave Penale, Model Pr 1Vp;
  - d. Evidenca e Zgjatjeve të Afatit të Hetimeve Paraprake, Model Pr 1Zgj;
  - e. Evidenca e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Model Pr 1Ek;
  - f. Evidenca e Treguesve të Marrëdhënieve Juridiksionale me Autoritetet e Huaja, Model Pr 1Mj, si dhe;
  - g. Evidenca mujore me Treguesit sipas Vendimeve Gjyqësore, Model Th 1Vgj.

---

<sup>1</sup> Shih, Urdhërin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 284, datë 19 . 12. 2002, i cili është plotësuar me urdhërin nr. 104, datë 24. 03. 2003.

1.1.1. Prokuroritë pranë Gjykatave Ushtarake të rrethit gjyqësor, të rnbajnë të dhënat statistikore, 3-mujore, 6-rnujore, 9-mujore dhe vjetore, si me poshtë:

- a. Evidenca e Referimeve të Veprave Penale Ushtarake, Model PrU 1R;
- b. Evidenca e Masave të Sigurimit, Model PrU lMs;
- c. Evidenca e Treguesve të Ndjekjes Penale sipas Veprave Penale Ushtarake, Model PrU lVp;
- d. Evidenca e Zgjatjeve të Afatit të Hetimeve Paraprake, Model PrU izgl;
- e. Evidenca e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Model PrU lEk;
- f. Evidenca e Treguesve të Marrëdhënieve Juridiksionale me Autoritetet Ushtarake të Huaja, Model PrU lMj, si dhe;
- g. Evidenca mujore me Treguesit sipas Vendimeve Gjyqësore, Model Th lVgjU.

1.1.2 Prokuroria për Krime të Rënda<sup>2</sup> të mbajë të dhëna statistikore, 3-mujore, 6-mujore, 9-mujore dhe vjetore, si më pashtë:

- a. Evidenca e Referimeve të Krimeve të Rënda, civile dhe Ushtarake, Model PrKR 1R dhe Model PrKRU 1R;
- b. Evidenca e Masave të Sigurimit, Model PrKR lMs dhe Model PrKRU 1 Ms;
- c. Evidenca e Treguesve të Ndjekjes Penale sipas Veprave Penale, Model PrKR lVp dhe Model PrKRU lVp;
- d. Evidenca e Zgjatjeve të Afatit të Hetimeve Paraprake, Model PrKR lZgj dhe Model PrKRU lZgj;
- e. Evidenca e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Model PrKR. lEk dhe Model PrKRU lEk;
- f. Evidenca e Treguesve të Marrëdhënieve Juridiksionale me Autoritetet e Huaja, Model PrKR lMj dhe Model PrKRU lMj, si dhe;
- g. Evidenca mujore me Treguesit sipas Vendimeve Gjyqësore, ModelThKRlVgj.

A. Çdo prokuror i Prokurorisë pranë Gjykatave të rrethit gjyqësor, civile dhe ushtarake, si dhe i Prokurorisë për Krime të Rënda<sup>3</sup>, i ndihruar nga operatorja/sekretarja, të mbajë dhe të plotësojë treguesit ep-unës së tij, në pasqyrat operative si vijojne:

- Pasqyra e Proçedimeve Penale në Hetimet Paraprake, Model p L hp;
- Pasqyra e Proçedimeve Penale të Pushuara, Model p lp;
- Pasqyra e Proçedimeve Penale të Pezulluara, Model p lpz;
- Pasqyra e Proçedimeve Penale të Dërguara në Gjykat, Model p ldgj;
- Pasqyra e Proçedimeve Penale të Gjykuara, Model p lgj;

1.2 Prokuroritë pranë Gjykatave të Apelit të mbajnë të dhënat statistikore, 3-mujore, 6-mujore, 9-mujore dhe vjetore, si më poshtë:

<sup>2</sup> Shih, piken 1 të urdhëTit nr. 104, datë 24.03.2004;

<sup>3</sup> Shih, po aty pika 2

- a. Evidenca e Treguesve për Çështjet e Shqyrtuara në Themel, sipas Prokurorive, Model Th 2Pr;
- b. Evidenca e Treguesve për Shqyrtimin e Masave të Sigurimit Personal, sipas Prokurorive, Model Ms 2Pr;
- c. Evidenca e Treguesve për Çështjet e Shqyrtuara në Themel, sipas Veprave Penale, Model Th 2Vp;
- d. Evidenca e Treguesve për Shqyrtimin e Masave të Sigurimit Personal, sipas Veprave Penale, Model Ms 2Vp, si dhe;
- e. Evidenca mujore me Treguesit sipas Vendimeve Gjyqësore, ModelTh2Vgj

1.2.1. Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Ushtarak të mbajë të dhënat statistikore, 3-mujore, 6-mujore, 9-rnujore dhe vjetore, si më poshtë:

- a. Evidenca e Treguesve për Çështjet e Shqyrtuara në Themel, sipas Prokurorive, Model Th 2PrU;
- b. Evidenca e Treguesve për Shqyrtimin e Masave të Sigurimit Personal, sipas Prokurorive, Model Ms 2PrU;
- c. Evidenca e Treguesve për Çështjet e Shqyrtuara në Themel, sipas Veprave Penale, Model Th 2VpU;
- d. Evidenca e Treguesve për Shqyrtimin e Masave të Sigurimit Personal, sipas Veprave Penale, Model Ms 2VpU, si dhe;
- e. Evidenca mujore me Treguesit sipas Vendimeve Gjyqësore, Model Th 2VgjU

1.2.2 Prokuroria e Apelit për Krime të Rënda<sup>4</sup> të mbajë të ihëna statistikore, 3-mujore, 6-mujore, 9-mujore dhe vjetore, si më poshtë:

- a. Evidenca e Treguesve për Çështjet e Shqyrtuara në Themel, sipas Prokurorive, Model Th 2PrKR;
- b. Evidenca e Treguesve për Shqyrtimin e Masave të Sigurimit Personal, sipas Prokurorive, Model Ms 2PrKR;
- c. Evidenca e Treguesve për Çështjet e Shqyrtuara në Themel, sipas Veprave Penale, Model Th 2KR;
- d. Evidenca e Treguesve për Shqyrtimin e Masave të Sigurimit Personal, sipas Veprave Penale, Model Ms 2KR, si dhe;
- e. Evidenca mujore me Treguesit sipas Vendimeve Gjyqësore, Model Th 2VgjKR.

1.3. Drejtoria Gjyqësore në këtë zyrë të mbajë dhe plotësojë të dhënat statistikore, 3-mujore, 6-mujore, 9-mujore dhe vjetore, për çështjet e përfaqësuara në Gjykatën e Lartë, si më poshtë:

- a. Evidenca e Treguesve për Çështjet e Themelit, sipas Prokurorive të Apelit dhe Prokurorive pranë Gjykatave të rretheve gjyqësore (civile dhe ushtarake), Model Th 3Pr;
- b. Evidenca e Treguesve për Masat e Sigurimit Personal, sipas Prokurorive të

---

<sup>4</sup> Shih po aty pika 3

Apelit dhe Prokurorive pranë Gjykatave të rretheve gjyqësore (civile dhe ushtarake), Model Ms 3Pr;

- c. Evidenca e Treguesve për Çështjet e Themelit, sipas Veprave Penale, Model Th 3Vp;
- d. Evidencën e Treguesve për Masat e Sigurimit Personal, sipas Veprave Penale, Model Ms 3Vp, si dhe;
- e. Evidenca mujore me Treguesit sipas Vendirneve Gjyqësore, ModelTh3Vgj.

1.4. Në të gjitha nivelet e Prokurorive, të mbahen të skeduar sipas renditjes në kohë dhe të ruhen të veçuara aktet më të rëndësishme procedurale të prokurorit, si më poshtë:

- a. Vendime të mosfillimit të procedimit, vendimet e shfuqizimit të tyre bashkëlidhur;
- b. Vendime të pushimit të çështjeve, si dhe për ato të cëzuar, vendimet e shfuqizimit të tyre bashkëlidhur;
- c. kerkesat për gjykimin e çështjeve;
- d. diskutimet ose konkluzionet përfundimtare, në tre nivelet e gjykimit, bashkëlidhur vendimet gjyqësore përkatëse;
- e. Apelimet dhe/ose rekurset, në tre nivelet e gjykimit, të vecuara:
  - për gjykime në themel dhe,
  - për masat e sigurimit personal.
- f. Urdhërat për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale të formës së prerë, bashkëlidhur me vendimet gjyqësore përkatëse të formës së prerë;
- g. Kërkesat që lidhen me marrëdhëniet juridiksionale me jashtë.

## **II. PLOTËSIMI DHE RUAJTJA E EVIDENCAVE STATISTIKORE SIPAS NIVEIBVE TË PROKURORIVE.**

2.1. Evidencat plotësohen me të dhëna të sakta dhe të kuadrueshme:

- me të dhënat e Regjistrit të Njoftimeve të Veprave Penale,
- me të dhënat e Pasqyrave të çdo prokurori sipas niveleve;
- me treguesit e vendimeve gjyqësore, si dhe;
- në vetevete e me njëra tjetrën.

2.2. Në Prokuroritë pranë Gjykatave të rrethit gjyqësor dhe në Prokurorinë për Krime të Rënda<sup>5</sup>, plotësimi i evidencave, sipas modeleve, të kryhet nga prokurorët e ngarkuar me mbajtjen e "Regjistrit të Njoftimit të Veprave Penale" të ndihmuar nga operatori/operatorja përkatëse, në mbikqyrjen e drejtuesit të Prokurorisë.

2.3. Në Prokuroritë pranë Gjykatave të Apelit dhe në Prokurorinë e Apelit për Krime të Rënda<sup>6</sup>, plotësimi i evidencave, sipas modeleve, të kryhet nga

---

<sup>5</sup> Shih po aty pika 4

<sup>6</sup> Shih po aty pika 5

oficeri i policisë gjyqësore pranë saj dhe/ose operatori/operatorja, në mbikqyrjen e drejtuesit të Prokurorisë së Apelit.

- 2.4. Në Drejtorinë Gjyqësore të kësaj zyre, plotësimi i evidencave, sipas modeleve, të kryhet nga operatorja e drejtorisë e ndihmuar nga sejcili prokuror që ka përfaqësuar çështjen në Gjykatën e Lartë, në mbikqyrjen e drejtorit përkatës.
- 2.5. Plotësimi i evidencave dhe pasqyrave statistikore të bëhet në kompjuter, sipas formularëve "Model Tip" përkatës, Ruajtja e tyre të bëhet në kompjuter dhe/ose në server, si dhe të printuara e të nënshkruara nga personat përgjegjës, të përcaktuar në këtë urdhër.
- 2.6. Të dhënat statistikore kanë karakter konfidencial (sekret statistikorë) dhe përdoren për qëllime kerkimore e studimore, përveç atyre që publikohen me dijeninë e drejtuesit të Prokurorisë sipas niveleve të saj.
- 2.7. Mënyra e mbajtjes, plotësimit, ruajtjes dhe raportimit të të dliënave statistikore përcaktohet në Udhëzimin përkatës të Prokurorit të Përgjithshëm.

### **III. RAPORTIMI I EVIDENCAVE STATISTIKORE.**

- 3.1. Prokuroritë pranë Gjykatave të rrethit gjyqësorë, Prokuroritë pranë Gjykatave të Apelit, prokuroritë për Krime të Rënda<sup>7</sup> dhe Diejtoria Gjyqësore e kësaj zyre, mbrenda datës 10 të çdo muaji dhe në muajt janar, prill, korrik e tetor, përkatësisht për periudhat vjetore, 3-mujore, 6-mujore dhe 9-mujore, të depozitojnë në zyrën e Statistikës të Drejtorisë së Studimeve të kësaj zyre, me CD dhe/ose Picodisk, si dhe të printuara, evidencat sipas modeleve me të dhënat statistikore përkatëse.
- 3.2. Evidencat shoqërohen me një relacion shpjegues të hollësishean në trajtë analize, për punën mujore, 3-mujore, 6-mujore, 9-mujore dhe vjetore të Prokurorisë sipas niveleve, ku të pasqyrohen:
  - tendencat e përhapje dhe shtrirjes së veprave penale<sup>^</sup> në përgjithësi dhe/ose grup apo veprave të vecanta;
  - treguesit e volumit të punë, efektivitetit të ndjekjes penale, cilësisë dhe shpejtësisë;
  - vështirësitë ose shqetësimet e evidentuara gjatë periudhës raportuese, si dhe;
  - mendime dhe/ose propozime për zgjidhjen e tyre.

### **IV. Zbatimi dhe Përgjegjësia për Shkeljet**

- 4.1 Për të ndjekur e kontrolluar zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen, prokurorët, operatorët dhe drejtuesit e Prokurorisë të të gjitha niveleve, si dhe të

---

<sup>7</sup> Shih po aty pika 6

strukturave të kësaj zyre.

- 4.2 Zyra e Teknologjisë së Informacionit të marrë masa që mbrenda datës 25 dhjetor 2002 të hedhë ne CD dhe/ose Picodisk, evidencat sipas modeleve me të dhënat statistikore përkatëse.
- 4.3 Zyra e Statistikes në Drejtorinë e Studimeve në bashkërendim me Zyrën e Teknologjisë së Informacionit mbrenda datës 31 dhjetor 2002 të organizojë seminare një ditore, sipas niveleve të prokurorive, me personat e ngarkuar për plotesimin e modeleve të evidencave statistikore.
- 4.4 Mospërmbushja e detyrave të përcaktuara në këtë urdhër, mospërgjigja në afat dhe pasaktësitë, për të dhënat statistikore, kur nuk formojnë vepër penale, përbëjnë shkelje të disiplinës në punë, neni 32 gërma "b" e ligjit Nr.8737 datë 12. 02. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë ne Republikën e Shqipërisë", etj.
- 4.5 Për shkelje të disiplinës në zbatimin e këtij urdhëri fillon procedimi disiplinore, ndaj prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore, operatorëve ose drejtuesve të Prokurorive të të gjithë niveleve.

#### **V. HYRJA NË FUQI**

- 5.1. Urdhëri Nr. 5/1 datë 8. 07. 1998 "Mbi vënien në zbatim të formularëve dhe evidencave të reja Statistike në fushën e veprave penale", si dhe çdo akt tjetër normativ i kësaj zyre që bie në kundërshtim me kërkesat e këtij urdhëri, shfuqizohen.
- 5.2. Me këtë urdhër të njihen operatorët, oficerët e policisë gjyqësore, prokurorët dhe drejtuesit e të gjithë niveleve të Prokurive.
- 5.3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

### **PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**THEODHORI SOLLAKU**

Azhornoi KL 5. 12. 06